

## THE USE OF EXPLOSIVES DURING TERRORIST ACTS AND THE DIFFICULTY OF IDENTIFYING THEM

**Milazim Shabani**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo,

**Sherif Sejdiu**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo,

**Abstract:** Since the discovery of black gunpowder by the Chinese before the new era, explosives have been used in most cases for destructive purposes.

The use of explosives during terrorist acts by individuals or criminal groups forced all states to require manufacturers of any type of explosives to have so-called relatively low markers or taggers (parts per million ppm or parts per trillion ppt), which at any time and space we can identify the manufacturer, type, quantity and series of explosives used. These chemicals are organic in nature (PMCH, perfluordimethylcyclohexane, DCH, perfluordecaline PFD, perfluordimethylcyclobutane PDCD) etc., which are packaged in microcapsules and their shelf life should be at least 5 years. The most commonly used and still used explosives by terrorist groups are: Semtex, RDX, PETN, C4, TNT, dynamite etc. Terrorist groups have recently been using artisanal explosives such as TATP (triacetone triperoxide), difficult to identify and practically easily manufactured. All anti-aircraft teams as well as all airports have explosive identification equipment which uses physico-chemical methods such as: X-ray analysis, neutron analysis, electromagnetic analysis, gamma ray analysis etc.

**Keywords:** PMCH, DCH, PFD, PDCD, Semtex, RDX, PETN, C4, TNT

## PËRDORIMI I EKSPLOZIVËVE GJATË AKTEVE TERORISTE DHE VËSHTIRËSITË E IDENTIFIKIMIT TË TYRE

**Milazim Shabani**

Kolegji Biznesi, Departamenti i Emergjencave, Prishtinë, Kosovë

**Sherif Sejdiu**

Kolegji Biznesi, Departamenti i Emergjencave, Prishtinë, Kosovë

**Përmbledhje:** Që nga zbulimi i barutit të zi nga Kinezët para erës së re e deri në ditët e sotme eksplozivët janë përdorur në të shumtën e rasteve për qëllime destruktive.

Përdorimi i eksplozivëve gjatë akteve teroriste nga individët apo grupet kriminale detyroi të gjitha shtetet që të kërkoj nga prodhuesit që qdo lloj eksplozivi të ketë të ashtuquajturit marker ose tagant me sasi relativisht të ulëta (pjesë për milion ppm ose pjesë për trilion ppt), që në qdo kohë dhe hapsirë të mund të identifikoj prodhuesin, llojin, sasinë dhe serinë e eksplozivit të përdorur. Këto substanca kimike janë me natyrë organike (PMCH, perfluordimetilcikloheksani, DCH, perfluordekalina PFD, perfluordimetilciklobutani PDCD) etj, që paketohen në mikrokapsula dhe jetëgjatësia e tyre duhet të jetë së paku 5 vjeqare. Eksplozivët që më së shumti janë përdorur dhe përdoren akoma nga grupet teroriste janë: Semtex, RDX, PETN, C4, TNT, dinamitet etj. Kohëve të fundit nga grupet teroriste janë duke u përdorur eksplozivët artizanal siq është TATP (treacetoni treperoksidi), vështirë i identifikueshëm dhe praktikisht lehtë i prodhueshëm. Të gjitha ekipet antiteror si dhe të gjitha aeroportet posedojnë aparatura identifikuese të eksplozivëve të cilat aparate përdorin metodat fiziko-kimike siq janë: analiza rentgenografike me rreze X, analiza neutronike, analiza elektromagnetike, analiza me rreze gama etj.

**Fjalët kyqe:** PMCH, DCH, PFD, PDCD, Semtex, RDX, PETN, C4, TNT,

### 1. HYRJJE

Historikisht, kërcënimet dhe aktet teroriste kanë ekzistuar përgjatë gjithë historisë së njerëzimit. Studimi i terorizmit është shumëdimensional, pasi këtij fenomeni duhet t'i qasemi nëpërmjet disiplinave të ndryshme, siç mund të jenë kriminologjia, shkencat politike, studimet e luftës dhe të paqes, gjeopolitika, shkencat e komunikimit apo studimet fetare etj.

Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhe arsyetojë dhunën si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit. Nuk ka asnjë profil të vetëm i cili do të përshkruante dhe përfshinte të gjithë aktet teroriste, sikurse nuk ekziston asnjë rrugë e vetme dhe e qartë, e cila i çon individët apo grupet në rrugën drejt akteve teroriste<sup>1</sup>.

Terrorizmi mund të konsiderohet gjithashtu një trashëgimi e përpjekjeve të lëvizjeve të ndryshme revolucionare, me shpërndarje gjeografike në të gjithë botën.

Termin terrorizëm për herë të parë e hasim gjatë Revolucionit Francez i udhëhequr nga Maksimilian Robespieri. Ndryshe nga përdorimi i tij bashkëkohor, asokohe, për një kohë relativisht të shkurtër, terrorizmi barte një konotacion pozitiv<sup>2</sup>.

Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërtuar në mënyrë unike për çdo rast specifik. Për të planifikuar, organizuar, si dhe zbatuar sulmet e tyre, terroristëve u duhen rekrutë, mbështetës, fonde, armë, mundësi udhëtimi pa pengesa, dhe forma tjera të mbështetjes materiale (si p.sh. mjete komunikimi, vende për t'u fshehur) si dhe akses ndaj objektivave të cënueshme. Që lufta kundër terrorizmit të jetë sa më efektive, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike ndaj këtyre grupeve, duke u bazuar dhe mbështetur tek një gamë e gjërë politikash dhe masash<sup>3</sup>.

Qasjet strategjike në luftën kundër terrorizmit shpesh përfshijnë disa objektiva, duke trajtuar stadi të ndryshme kronologjike, sipas ndodhjes së akteve të tilla<sup>4</sup>.

Këto objektiva në mënyrë të përgjithshme mund të kategorizohen si më poshtë:

- ✓ Parandalimi me kohë i individëve për t'u bërë terroristë
- ✓ Dhënia e mundësisë për t'u tërhequr dhe sigurimi i mbështetjes për individët që janë në rrugën drejt akteve Terroriste ose janë të përfshirë në të
- ✓ mohimi i mbështetjes, burimeve dhe mjeteve për t'u organizuar apo planifikuar dhe realizuar sulmet për Personat e dyshuar si terroristë
- ✓ Përgatitje dhe mbrojtje ndaj akteve terroriste
- ✓ Ndjekja e të dyshuarve si terroriste, me qëllim parandalimi i këtyre akteve, kapjen dhe nxjerrjen e tyre përpara drejtësisë dhe
- ✓ Reagimi ndaj sulmeve terroriste përmes masave proporcionale për zbutjen e impaktit të këtyre sulmeve dhe për t'u ardhur në ndihmë viktimave.

Shtetet kanë detyrimin e sigurimit të mbrojtjes kundrejt akteve terroriste dhe kjo kërkon prej tyre vendosjen e një theksi të posaçëm tek parandalimi i terrorizmit Gjithashtu shtetet, përmes agjensive të tyre policore dhe të sigurisë, kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë individëve brenda juridiksionit të tyre<sup>5</sup>.

Politikat dhe masat antiterrorizëm, si çdo veprim tjetër i ndërmarrë nga autoritetet publike në një shtet demokratik, duhet të jenë me kohë dhe të përgjegjshme<sup>6</sup>. Në mënyrë që lufta kundër terrorizmit të jetë efektive dhe e qëndrueshme, ajo duhet të përputhet gjithnjë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Reagimi i shtetit ndaj kërcnimeve dhe akteve terroriste duhet të jetë i bazuar mbi fakte dhe të jetë proporcional, me qëllim shmangien e humbjes së besimit dhe mbështetjes së popullatës, si dhe shmangien e viktimizimit dhe formave tjera të vlerësimit të historive të akteve terroriste<sup>7</sup>.

Për më tepër, reagimi i shtetit nuk mund të kufizohet vetëm tek veprimet represive të përqendruara tek ndjekja, kapja dhe eliminimi i individëve dhe grupeve terroriste. Ndër kushtet që mund të favorizojnë terrorizmin, përfshijnë: “konfliktet e zgjatura të pazgjidhura, zhveshja nga aspektet njerëzore e viktimave të terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij, mungesa e sundimit të ligjit, shkelja e të drejtave të njeriut, diskriminimi për shkak të përkatësisë etnike, kombëtare dhe fetare, përjashtimi politik, marginalizimi shoqëror dhe ekonomik, keqëqeverisja”<sup>8</sup> etj.

## 2. EKSPLOZIVËT DHE EKSPLODIMET

Eksplodivet janë substanca kimike të cilat për një kohë shumë të shkurtë zbërthehen dhe lirojnë sasi shumë të mëdha të energjisë në forma të ndryshme si dhe krijojnë shtypje shumë të lartë të cilat kanë efekte shkatërruese sizmike, akustike, optike, termike etj. në hapësirën ku ndodhë shpërthimi<sup>9</sup>.

Eksplodimet klasifikohen në tri grupe kryesore:

- eksplozimet fizike
- eksplozimet kimike
- eksplozimet nukleare

Vala goditëse pas një eksplozimi, pas rritjes së shpejtë dhe të madhe të shtypjes atmosferike (disa milisekonda) shkakton të ashtëquajturën shtypje dinamike, e cila ka efekte destruktive në objekte dhe hapësirë. Vala goditëse varet nga lloji si dhe sasia e eksplozivit. Përveq valës goditëse dinamike gjatë eksplozimit lirohen shumë gazra të ndryshme që kanë efekte helmuese si dhe shkaktojnë dëmtime të ndryshme fizike. Dëmtimet mund të klasifikohen në dëmtime primare, sekondare dhe terciare.

Efektet kryesore negative të eksplozimeve janë efektet sizmike, efekti i goditjeve valore, efektet termike si dhe efektet akustike.

### 3. AKTET TERORISTE DHE EKSPLOZIVET

Viteve të fundit bota është duke u përballur gjithnjë e më shumë me sulmet vetëvrasëse të individëve, apo grupeve, duke përdorur eksplozivë të ndryshëm. Këto sulme vetëvrasëse mund të kryhen në mënyra të ndryshme siq janë: makina bombë, anije motorike të shpejta, motoçikleta, si dhe aktet e kidnapimit dhe rrëzimit të aeroplanëve civil<sup>10</sup>. Eksplozivët që më së shumti janë përdorur gjatë akteve terroriste janë: Semtex, RDX, PETN, C4, TNT, dinamitet e ndryshme siq janë eksplozivët plastikë, zhelatinoz dhe eksplozivët e lëngshëm<sup>11</sup>.

Sipas mënyrës së prodhimit dallojmë tre grupe të eksplozivëve:

- eksplozivët ushtarak dhe komercial
- eksplozivët e improvizuar ose artizanal
- eksplozivët special

Grupet terroriste në të shumtën e rasteve përdoren eksplozivët e improvizuar, të përgatitur nëpër shtëpi të ndryshme në mënyrë shumë sekrete. Aktivizimi i tyre bëhet duke rekrutuar fëmijë, gra të veja, individ ekstremist fetar etj, të cilët kryesisht kanë motive hakmarrëse.

Kidnapimi dhe rrezimi i aeroplanëve civil, gjithmone ka qenë një rrezik permanent sepse fillimisht ka qenë e lehtë futja e substancave të parrezikshme në aeroplan e që më vonë kanë shërbyer si prekursor të përfuturit të përzierjeve eksplozive.

Në ditët e sotme gati është e pamundur futja e këtyre substancave sepse janë rritur masat e sigurisë nëpër aeroporte si dhe janë zbuluar metoda dhe aparatura të reja detektuese.

### 4. MARKERËT (TAGANTËT) QË PËRDOREN GJATË IDENTIFIKIMIT TË EKSPLOZIVËVE

Gati të gjithë eksplozivët ushtarak dhe komercial në molekulat e tyre përmbajnë elementet kimike siq janë: Hidrogjeni(H), Oksigjeni(O), Karboni(C), dhe Azoti(N). Vetëm një numër i vogël i eksplozivëve perokside organike siq është TATP (treacetoni treperoksidi), nuk përmbajnë fare azot.

Një numër i caktuar i këtyre eksplozivëve përmbajnë edhe elemente tjera siq janë, Alumini, Bariumi, Bori, Hekuri, Plumbi, Merkuri, Fosfori, Fluori etj të cilat mund të identifikohen me metodën spektroskopike. Disa veti kryesore të eksplozivëve shërbejnë për identifikimin e tyre gjatë ruajtjes dhe përdorimit. Këto veti kryesore janë: densiteti i lartë i azotit, sasia apo përqindja e azotit në grupe funksionale kimike që njëherit janë bartës edhe të oksigjenit, densitet shumë të lartë të substancave baze të një eksplozivi në krahasim me densitetin e ujit, polaritet të lartë të grupeve që përmbajnë azot dhe oksigjen, stabilitet të ulët të këtyre grupeve në temperature të ulëta dhe të larta, veti të lartë adsorbuese si dhe lirim të gazrave që shkaktojnë kontaminim të ajrit si dhe iritim të lëkurës. Pas një shpërthimi, sasia e substancave detektuese detyrimisht duhet të jetë prezente në rrethinën ku ndodhë eksplozimi në sasi prej 1000 miliuntënjësë(ppm), ose edhe në triliontën pjesë (ppt). Prezenca e këtyre substancave (tagantët) matet me instrumente special detektuese.

Tagantët (eng. Taggant), paraqesin substanca të cilat iu shtohen eksplozivëve gjatë procesit të prodhimit për shkak të mundësisë së identifikimit ose detektimit të tyre. Këto substanca në vetvete përmbajnë “substanca koduese”, përmes së cilës në qdo kohë mund të identifikohet një eksploziv, prodhuesi si dhe serisa e eksplozivit. Këto substanca u mundësojnë detektorëve që të zbulojnë përmbajtjen eksplozive edhe poqese ato janë të mbyllura hermetikisht<sup>12</sup>.

Si substanca detektuese më së shpeshti përdoren mikrokapsulat të cilat emitojnë sasira shumë të vogla të avujve detektues. Këto mikrocelula mund të “jetojnë” detonimeve të fuqishme të cilat pastaj mund të detektohen dhe të dekodohen eksplozivi.

Substancat detektuese duhet të plotësojnë këto kushte:

- nuk duhet të gjenden në natyrë
- duhet të lirojnë avuj së paku 5 vjet (e dëshirueshme 10 vjet)
- duhet të mundësojnë detektimin në përqendrime shumë të ulëta të shprehura në bilion apo trilion(ppb,ppt)
- avujt nuk duhet të kenë veti absorbuese ndaj objekteve
- duhet të kenë veti kompatible me substancat eksplozive Si substanca detektuese më herët janë përdorë perfluor alkanet vijuese: perfluormetilcikloheksani(PMCH), perfluordimetilcikloheksani(DCH), perfluordekalina(PFD), perfluordimetilciklobutani(PDCD) etj. Këto substanca paketohen në mikrokapsula dhe jetëgjatësia e tyre duhet të jetë së paku 5 vjeqare (e dëshirueshme 10). Më vonë organizata ndërkombëtare e aviacionit civil propozoi që prodhuesit e eksplozivëve të përdorin si substanca detektuese dinitratetilenglikoli (EGDN), orto-mononitrotoluenin(o-MNT), para-mononitrotoluenin(p-MNT), dhe 2,3-dimetil-2,3-dinitrobutani(DMND). Përqendrimi i këtyre komponimeve tek eksplozivët duhet të jetë 0,2, 0,5, 0,5 dhe 0,1%. Çdo lloj eksplozivi, përshkak të vetive fiziko- kimike, duhet të ketë një detektor të veçantë<sup>13</sup>.

Aparaturat teknike që përdoren gjatë identifikimit të llojit dhe serisë së eksplozivit përdorin teknikat siq janë : analiza rentgenografike me rreze X, analiza neutronike, analiza elektromagnetike , analiza me rreze gama etj

## 5. PËRFUNDIM

Terrorizmi paraqet një strategji të përdorimit të dhunës si rrugë dhe mënyrë më e shpejtë të arritja e rezultatit të instalimit të frikës dhe pasigurisë. Shtetet, në veçanti përmes agjencive të sigurisë, ushtrisë, policisë, inteligjencës etj., kanë detyrim të garantojnë siguri dhe mbrojtje nga aktet terroriste për të gjithë individët brenda juridiksionit të tyre, si dhe të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut. Kjo kërkon që ata të miratojnë një qasje gjithëpërfshirëse në lidhje me përballjen me terrorizmin, duke u përqendruar në veçanti tek aspektet e parandalimit dhe përballjes me këto akte kriminale, Duke qenë se policia luan një rol qendror në përballjen me terrorizmin, është shumë e rëndësishme që të ketë një bashkëpunim dhe të japë llogari për veprimet e saj me qëllim garantimin e legjitimitetit, besimit dhe mbështetjes së popullit. Globalizmi dhe ndryshimi i situatës së një numri të madh shoqërorish kanë prodhuar tensione brenda shoqërive, duke i nxitur njerëzit t'i kushtojnë vëmendje më të madhe fesë për të siguruar mbështetje mendore dhe psikologjike në një botë dinamike e në ndryshim të vazhdueshëm. Nga pikëpamja gjeopolitike vihet re se terrorizmi është zhvendosur prej të qenit brenda të njëjtës hapësirë kulturore drejt akteve terroriste përtej linjave ndarëse mes qytetërimeve dhe midis sferave të ndryshme kulturore. Këto ndasi kulturore janë bërë më të rëndësishme me fundin e Luftës së Ftohtë, ndërsa feja është shndërruar në një burim permanent identifikues i akteve terroriste. Shumë raste të suksesshme të akteve terroriste, si dhe zbulimi në momente të fundit të eksploziveve e kanë bërë të detyruar hulumtimin dhe gjetjen e mënyrave të zbulimit me kohë dhe parandalimin e aktivizimit të eksplozivëve pa marrë parasysh rrugën, motivin dhe mënyrën e kryerjes së këtij akti. Praktika ka treguar se aktet më të shpeshta dhe më të thjeshta janë aktet e vetëvrasjes së individëve me eksplozivë të ndryshme<sup>14</sup>.

Eksplozivët që më së shumti janë përdorur gjatë këture sulmeve janë: RDX, PETN,C4,TNT, Dinamitet si dhe prodhimet artizanale.Aktet terroriste më të njohura ku është përdorur eksploziv janë : sulmi në metrot e Madridit 2004, të Londrës 2005, tregun e Kairos 2009 etj. Në këto aksione është përdorur eksplozivi TATP (treacetoni treperoksidi) i zbuluar më 1895 dhe i rizbuluar kohëve të fundit nga grupet terroriste të lindjes së mesme.

## LITERATURA

- Geoffrey, J., (1996) (eds.) “*Security Challenges in the Mediterranean Region*”, London: Franc Cass,  
Lutz, J., & Lutz, B., (2008) “*Global Terrorism*”, 2nd edn, Nju Jork: Routledge, f. 20 & 137.  
McCauley, C.R. (2008), „The Psychology of Terrorism”, Social Science Research Council,  
[www.ssrc.org/sept11/essays/mccauley.htm](http://www.ssrc.org/sept11/essays/mccauley.htm) (23.09.2008.)  
Rigstad, M., (2008) “The Senses of Terrorism”, në “*Review Journal of Political Philosophy*”, Vëll. 6, Nr. 1, f. 76.  
Scheinin, M., (2010) “Ten areas of best practices in countering terrorism”22 dhjetor 2010, Dokument A/HRC/16/51  
Schmid, A. P., (2011) (ed.), “*The Routledge Handbook of Terrorism Research*”, Nju Jork: Routledge, 2011, f. 2.  
Schubert, H., Kuznetsov, A., (2006) *Detection and Disposal of Improvised Explosives*, Proceedings of the NATO Advanced Research Workshop on Detection and Disposal of Improvised Explosives, St. Petersburg, Russia, 7-9 September 2005, Springer, Netherlands, 2006.  
Wilkinson, P., (1986) “*Terrorism and the Liberal State*”, Macmillan, London, f. 51.  
Yinon, J., (1999) *Forensic and Environmental Detection of Explosives*, John Wiley & sons, Ltd  
“The Bucharest Plan of Action for Combating Terrorism”, Bukuresht, 4 dhjetor 2001  
“OSCE Consolidated Framework for the Fight Against Terrorism”, 7 dhjetor 2012,  
*Guidebook on Democratic Policing by the Senior Police Adviser to the OSCE Secretary General* Vjene: vellimi i dyte, 2008  
*Countering Terrorism, Protecting Human Rights*, Varshave: OSBE/ODIHR, 2007